REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 37/17
Datë/Datum. 01.03.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit **Komuna Ferizaj**	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
Prej:	Visar Basha – Ekspert shqyrtues i prokurimit		
Lënda:	Ekspertiza lidhur me Ankesën Nr. **37/17** e OE **"Art Trade"** - Ferizaj.		
Datë:	01.03.2017		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik të Kosovës ju njoftojmë me raportin e ekspertizës, lidhur me ankesën e parashtruar me dt: 06.02.2016 me Nr. **37/17** nga OE **"Art Trade"** - Ferizaj, për shqyrtimin e lëndës: **"Vlerësimi i strategjisë mjedisore të planit zhvillimor komunal – Lot 1"** dhe **"Vlerësimi i strategjisë mjedisore për harta zonale komunale – Lot II"**, me numër të prokurimit: 656/17/352/322, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna Ferizaj.**

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA FERIZAJ.**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP.**
- OE ankues – **ART TRADE.**

		22.02.2017		**22.02.2017**		**01.03.2017**
Nënshkrimi i ekspertit		*Data e autorizimit të eksp.*		*Data e fillimit të ekspertizës*		*Data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën 06.02.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. 37/17 e parashtruar nga OE **"Art Trade"**, me seli në Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Vlerësimi i strategjisë mjedisore të planit zhvillimor komunal – Lot 1"** dhe **"Vlerësimi i strategjisë mjedisore për harta zonale komunale – Lot II"**, me numër të prokurimit: 656/17/352/322, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna Ferizaj.**
Konform nenit 113 te Ligjit Nr. 04/L-042, Eksperti Shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK) – **Komunës së Ferizajit.**

N.111 i LPP-së - Operatori Ekonomik Ankues "Art Trade", me seli në Prishtinë.

Pikat e Ankesës nga OE **"Art Trade"** *- dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:*
Neni 46 - Rregullat e posaçme për mundësimin e shkurtimit të afateve kohore;

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:
Për tenderin Lot I, vlerësimi strategjisë mjedisor te planit zhvillimore komunal dhe Lot II vlerësimi strategjisë mjedisore për harta zonale komunale, nr. i prok. FE 656/17/004/322 gjegjësisht 656/17/352/322 nuk janë respektuar dispozitat sipas ligjit nr. 04/L-042 për prokurim publik re R. Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237, ligjin nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.

Njoftimi për kontratë për tenderin e lartcekur ka qene me date: 30.01.2017.

Afati i fundit për pranim te tenderëve është planifikuar te behet me date: 07.02.2017 ne ora 14:00.

Duke u bazuar ne nenin IV.3.1 dhe nenin IV.3.3 te këtij njoftimi për kontratë dhe duke u ndërlidhur me dispozitat e LPP-se neni 46 paragrafi 3 afati i fundit për pranimin e tenderëve duhet te jet se paku 15 dite nga publikimi i njoftimit për kontratë.

Neni 46 - Rregullat e posaçme për mundësimin e shkurtimit të afateve kohore

3. Gjatë një aktiviteti të prokurimit që përdor **procedurat e kufizuara**, autoriteti kontraktues mund të caktojë një afat kohor që: (i) nuk është më i shkurtër se pesëmbëdhjetë **(15) ditë**, për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje; dhe/ose (ii) nuk është më i shkurtër se dhjetë **(10) ditë**, për pranimin e tenderëve.

Poashtu ka shkelje ne aspektin teknik ku bie ne kundërshtim me ligjin për planifikim hapësinor.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP :	30.01.2017
Lloji i procedurës së aplikuar:	Procedurë e Kufizuar
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:	Shërbime këshilluese/vlerë e mesme
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë):	07.02.2017
Data e hapjes së ofertave	07.02.2017-14:00^{h}
Kriter për dhënie të kontratës:	*Tenderi ekonomikisht më i favorshëm*

Neni 108/A - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

OE ankues konform nenit 108/A ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, me pretendimin e njëjtë ankimor, ku ka kërkuar qe te respektohet neni 46 i LPP-se. AK-ja, pas analizimit e refuzon ankesën si të pa bazuar.

Përgjigjet e ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimet ankimore të OE ankues:

Sqarimi nr.1

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues pretendon se AK-ja, nuk e ka respektuar afatin kohor për pranimin e tenderëve te përcaktuar ne dispozitat e LPP-se, përkatësisht nenin 46 të LPP-së dhe njëherit sqaroj se OE ankues ushtron ankesë në fazën e kritereve.

Sqarimi nr.2

Eksperti shqyrtues, pas analizimit të dokumentacionit, sqaron se njoftimi për kontratë për aktivitetin e prokurimit: "Vlerësimi i strategjisë mjedisore të planit zhvillimor komunal – Lot 1" dhe "Vlerësimi i strategjisë mjedisore për harta zonale komunale – Lot II", është publikuar me datë 30.01.2017.
AK-ja, në njoftimin për kontratë në pikën: IV.3.2 ka paraparë që afati i fundit për pranimin e ofertave të jet me datë: 07.02.2017.

Në lidhje me afatin për pranimin e ofertave, eksperti shqyrtues, sqaron se AK-ja, në pikën IV.3.3 të njoftimit për kontratë ka paraparë shkurtim të afatit për dorëzim të ofertave.

Sqarimi nr.3

Eksperti shqyrtues, pas ka analizuar pretendimin ankimore të parashtruar nga OE ankues "Art Trade", sqaron se ky pretendim është i qëndrueshëm për faktin se sipas dispozitave të paragrafit 3 të nenit 46 të LPP-së, pikës (ii), shkurtimi i afatit për pranim të tenderëve nuk është më i shkurtër se 10 ditë.
Në rastin konkret, eksperti shqyrtues duke u bazuar në datën e publikimit të njoftimit për kontratë dhe afatit të paraparë për pranim të ofertave, sqaron se AK-Komuna e Ferizajit ju ka dhënë afat operatorëve ekonomik vetëm 8 ditë, gjë që është në kundërshtim me nenin e lartpërmendur.

Prandaj, duke u bazuar në sqarimin e lartpërmendur eksperti shqyrtues, vlerëson se AK-ja, nuk i ka respektuar dispozitat e nenit 46 të LPP-së, për shkurtimin e afateve, andaj i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar ndërsa në lidhje me aktivitetin e prokurimit të obligohet AK-ja, që të respektoj nenin 46 të LPP-së dhe njëherit të ju dërgoj OE-ve njoftimin për shtyje të afatit për pranim të ofertave.

Mendimi i ekspertit shqyrtues :

- Eksperti shqyrtues bazuar në konstatimet e cekura në ekspertizë mendon që Autoriteti Kontraktues – **Komuna Ferizaj (KF)**, për aktivitetin e prokurimit **"Vlerësimi i strategjisë mjedisore të planit zhvillimor komunal – Lot 1"** dhe **"Vlerësimi i strategjisë mjedisore për harta zonale komunale – Lot II"**, me numër të prokurimit: 656/17/352/322, nuk i ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP-së.
- Prandaj eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ta obligoj AK-ne, qe ta zgjas afatin dhe njëherit te njoftohen OE-te.